

NJOFTIM PËR SHTYP

PËR PËRCAKTIMIN NGA AKADEMIJA E SHKENCAVE TË NJË ANËTARI DHE TË NJË ANËTARI ZËVENDËSUES SI PËRFAQËSUES NË KOMISIONIN E PAVARUR AD HOC PËR VERIFIKIMIN PARAPRAK TË KANDIDATËVE PËR ANËTARË TË KLGJ DHE KLP NGA RRADHËT E AVOKATISË

Pas kërkesës së Avokatit të Popullit, në kuader të procedurave për ngritjen dhe funksionimin e Komisionit të Pavarur Ad Hoc për verifikimin dhe vlerësimin paraparak të kandidatëve për anëtarë të Këshillit të lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga rradhët e avokatisë, si dhe në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga neni 23 dhe 25 i ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të Drejtësisë”, i ndryshuar, në datën e sotme institucioni i Akademisë së Shkencave ka komunikuar emrat e anëtarit dhe anëtarit zëvendësues për Komisionin e Pavarur Ad Hoc si më poshte:

1. Akademik Shaban Sinani- anëtar;
2. Akademik i asocuar Adrian Civici – anëtar zëvendësues.

Ky njoftim bëhet në kuadër të transparencës për procesin e përzgjedhjes së anëtarëve nga avokatia në Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë.